# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443573**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Publikoi pamje nga protesta/ Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa, PD: Narkopolicia nuk do ta fitojë betejën me fjalën e lirë |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/publikoi-pamje-nga-protesta-kercenimi-me--i-gazetarit-osman-sta-i514105` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 15:12:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 15:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `83f8f4966a4f83d1c98203a5a0b696bba8e68d92e5508fe0b23b625faac0ba00` |
| TEKSTI | `ae6a5fa9034ce242db6cc582cecc927031db68a2a7d4e14ea1c7bdd7b843f99d` |
| PAMJA | `c7be5508181605d4182cdaa7a2d8726315633cc493bbc06559a5f4b833b269c7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `596fa2618b9fab8311d4b635eee1f07339531eb067ee3e1d974a9e3259bf77d3` |
| E MËPARSHMJA | `2e556767d81ba6386218c405b25fde82987f943a2257a34757c18f9460343929` |
| RRËNJA MERKLE | `c5c495e1993bed01ae9e3c22701c0f0e7f56228ef65729414d07abaefa87f787` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/596fa2618b9fab8311d4b635eee1f07339531eb067ee3e1d974a9e3259bf77d3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Publikoi pamje nga protesta/ Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa, PD: Narkopolicia nuk do ta fitojë betejën me fjalën e lirë

Në fund të deklaratës, Partia Demokratike shprehet se qëndron në solidaritet të plotë me Osman Stafën dhe me çdo gazetar që mbron interesin publik.

dosja
14 Shtator 2026, 17:00
Nga E. D



Partia Demokratike

**TIRANË-** Partia Demokratike ka reaguar në lidhje me kërcënimin me jetë ndaj gazetarit Osman Stafa pas publikimit prej tij të pamjeve nga protesta përpara Kuvendit. Me anë të një deklarate, PD thekson se rasti nuk mund të trajtohet si një episod i vetëm dhe se kjo ngjarje është pjesë e një klime gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë, të krijuar nga një qeveri që i përgjigjet denoncimit me presion, intimidim dhe frikësim

PD kërkon identifikimi dhe vënien përpara drejtësisë të autorit të kërcënimit; zbardhjen e lidhjes së mundshme ndërmjet kërcënimit dhe pamjeve të publikuara; identifikimin zyrtar të katër punonjësve të policisë dhe sqarimin e urdhrave mbi bazën e të cilëve kanë vepruar pa uniformë; dhe vlerësimin e rrezikut dhe garantimin e mbrojtjes së gazetarit Osman Stafa. Në fund të deklaratës, Partia Demokratike shprehet se qëndron në solidaritet të plotë me Osman Stafën dhe me çdo gazetar që mbron interesin publik.

**Deklarata e PD-së:**

*Partia Demokratike dënon me forcë kërcënimin me vdekje ndaj gazetarit të News24, Osman Stafa, pas publikimit prej tij të pamjeve nga protesta përpara Kuvendit.*

*Katër personat me veshje civile të dokumentuar në pamje gjatë ndalimit të një protestuesi janë punonjës policie. Fakti që efektivë të Policisë së Shtetit ndërhyjnë pa uniformë dhe pa shenja identifikuese ndaj protestuesve paqësorë ngre shqetësime serioze për veprime të paligjshme dhe përpjekje për t'iu shmangur përgjegjësisë.*

*Kërcënimi ndaj gazetarit pas publikimit të këtyre pamjeve nuk mund të trajtohet si një episod i zakonshëm. Ai duhet hetuar urgjentisht, duke përcaktuar jo vetëm autorin e mesazhit, por edhe nëse kërcënimi lidhet me ekspozimin e punonjësve të policisë dhe me veprimtarinë profesionale të gazetarit.*

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 15:41
"Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale

POLITIKE 14 SHTATOR 2026, 14:44
A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë

*Kjo ngjarje është pjesë e një klime gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë, të krijuar nga një qeveri që i përgjigjet denoncimit me presion, intimidim dhe frikësim. Kur gazetarët kërcënohen sepse dokumentojnë sjelljen e policisë, synimi është i qartë: të heshtet media, të fshihen abuzimet dhe qytetarët të privohen nga e drejta për të ditur të vërtetën.*

*Partia Demokratike kërkon:*

*-identifikimin dhe vënien përpara drejtësisë të autorit të kërcënimit;*
*-zbardhjen e lidhjes së mundshme ndërmjet kërcënimit dhe pamjeve të publikuara;*
*-identifikimin zyrtar të katër punonjësve të policisë dhe sqarimin e urdhrave mbi bazën e të cilëve kanë vepruar pa uniformë;*
*-vlerësimin e rrezikut dhe garantimin e mbrojtjes së gazetarit Osman Stafa.*

*Heshtja ose zvarritja nga institucionet do të përbënte mbrojtje politike për kërcënuesit dhe një mesazh frikësues për çdo gazetar që guxon të dokumentojë abuzimet e pushtetit.*

*Partia Demokratike qëndron në solidaritet të plotë me Osman Stafën dhe me çdo gazetar që mbron interesin publik.*
*Narkopolicia nuk do ta fitoje betejen me fjalën e lirë./***Dosja.al**

partia demokratike

## Sondazh

Poll

Aktualitet

14 Shtator 2026, 16:40

# Rrogat e magjistratëve do rriten 8500 lekë, Komisioni i Ekonomisë miraton në parim draftin e PS

Komisioni i Ekonomisë TIRANË- Komisioni i Ekonomisë miratoi në parim draftin e mazhorancës për pagat e magjistratë...

### Kërcënimi ndaj gazetarit Osman Stafa/ SafeJournalist: Autoritetet ta hetojnë urgjentisht, të merren masat për sigurinë e tij

Aktualitet

14 Shtator 2026, 15:54

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 10:49

### SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektivi i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark

## më të klikuarat

**Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatrinë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim**

**Tension te Zogu i Zi/ Protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre (VIDEO)**

**SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektivi i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark**

**Dha alarm fals për bombë në shkollën "Emin Duraku", arrestohet Edmond Jatagani**

## insights

Ola Xama

**Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen**

Idriz Konjari

**Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?**

Bledian Koka

**Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?**

Fjola Graçi

**REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"**

## Moti

Powered by tomorrow.io

### "Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale

Aktualitet

14 Shtator 2026, 15:41

### Kontroll blic me urdhër të SPAK-ut në sektorin ku mbahet Ergys Agasi. Gjenden pajisje wireless dhe alkool!

Aktualitet

14 Shtator 2026, 14:53

### Qëlloi në bark protestuesin e prangosur, pezullohet nga detyra efektivi

Aktualitet

14 Shtator 2026, 14:34

Aktualitet

14 Shtator 2026, 13:41

## Aksident rrugor në aksin Fier–Mallakastër, plagosen tre persona

Foto ilustruse FIER- Një aksident rrugor ka ndodhur në aksin rrugor dytësor që lidh Fierin me Mallakastrën, në vendin e quajt...

### Viti i ri shkollor 2026-2027/ Mbyllet shkolla në Eçmenik të Devollit, kishte vetem dy nxënës

Aktualitet

14 Shtator 2026, 13:10

### VIDEO/ Kapen 41 kg e 350 gramë kokainë në Portin e Durrësit nga Brazili. Vlera në treg 2 milionë euro

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:59

### Aksident i rëndë rrugor në Peqin/ Audi përplas të moshuarin, 70-vjeçari ndërron jetë rrugës për në spital

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:03

### Theu urdhrin e mbrojtjes dhe plagosi me drapër ish-vjehrrin, arrestohet daja i Zegjine Çaushit në Roskovec

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:08

**MË SHUMË**




## Braçe kritika të ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Të kërkojnë falje



Braçe kritika të ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Të kërkojnë falje



Berisha:Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës



Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin tonë për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Edi Rama



Berisha: Denoncuam farsën elektorale, sekretari Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet!

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS
EDITORIAL

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.